



Ne pajtim me mandatin që i është dhënë dhe konform Statutit të kompanisë, menaxhmenti i KUR „Hidroregjioni Jugor“ në Prizren, me datë 04.02.2011 miraton dhe publikon këtë:

## **RREGULLORE**

### **mbi ndalimin e pirjes së duhanit në objektet e KUR „Hidroregjioni Jugor“ sh.a, Prizren**

#### Neni 1

Duke marrë parasysh obligimet që dalin nga Ligji Nr.02/L-36 për Duhanimin, ku qëllimi i këtij ligji është të mbrojtë shëndetin e popullatës përgjithësisht mjedisin e punës, me saktësiht neni 10 pika 10.10 i cili thekson „në vendet e punës ku është e ndaluar pirja e duhanit nuk duhet të jenë të vendosura take-tuket“.

Duke pas parasysh pasojat e dëmshme që sjell duhani për shëndetin e njeriut sidomos konsumuesit pasiv të tij dhe mbrojtjen e ambientëve të punës brenda objekteve të kompanisë, miratohet Rregullorja e cila ka për qëllim ndalimin e pirjes së duhanit brenda objekteve të KUR „Hidroregjioni Jugor“ në Prizren, me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani dhe për arsye të mirembajtjes së pastërtisë të ambientëve të punës në KUR „Hidroregjioni Jugor“.

#### Neni 2

Ndalohet pirja e duhanit nëpër të gjitha njesit, fabrikat, zyret, korridoret, WC-te, automjetet dhe vende të tjera brenda objektit të KUR „Hidroregjioni Jugor“, duke vendosur shenja të madhësisë 40 cm<sup>2</sup>, me mbishkrimin ndalohet repressisht pirja e duhanit, në vende ku mund të lexohen nga largësia prej 5m .

#### Neni 3

Për duhan piresit vend i pirjes së duhanit caktohet hapsira jashtë objektit e cila mund të përdoret si vend ku ekskluzivisht pihet duhani në kompani.

#### Neni 4

Të gjithë punëtorët të cilët gjinden duke pirë duhan në vend të punës ku ata punojnë apo vende të tjera të kompanisë, si në nenin 2, gjobiten me zbritje prej 5% të pagës neto mujore.

#### Neni 5

Me qëllim të zbatimit rigoroz të kësaj rregulloreje obligohen të gjithë personat të cilët vërejnë njerëz të cilët pijnë duhan brenda objektit të kësaj kompanie t`a lajmrojnë sigurimin e kompanisë për largimin e tyre jashtë objektit të KUR „Hidroregjioni Jugor“ në Prizren.

#### Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të së njëjtës nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kryeshefi Ekzekutiv,

\_\_\_\_\_  
Besim Baraliu